

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-52/12

Prishtinë, 7 gusht 2012

Në çështjen juridike të

K.N.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

SOE "P",

E përfaqësuar nga R.S.

Pala përgjegjëse në kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/132/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 00442), të datës 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 7 gusht 2012 dhe në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 12.2 po aty në lidhje me nenin 465.1 të Ligjit Mbi Procedurën Kontestimore, morri këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e K.N. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/132/2011 për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA 00442
- 2- Konfirmohet vendimi KPCC/D/R/132/2011 për sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA 00442.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 530 (pesëqind e tridhjetë euro) në buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 26 shkurt 2007, N.K. (paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në emër të bartësit të së drejtës pronësore B.K. në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ku ka kërkuar ri-posedimin e një objekti komercial me sipërfaqe prej 783 metra katrorë, që ndodhet në Prishtinë, 24 “Zeleznicka” dhe të ngastrave 7155/1 dhe 7154/1. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se ai është pronari i vetëm i pronës dhe ka paraqitur aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës 1893/05 të datë 27.12.2005 të marrë nga Gjykata Komunale në Prishtinë.

Paraqitësi i kërkesës ka cekur se ndërmarrja shoqërore (NSH) “I.” si uzurpues të pronës.

Paraqitësi i kërkesës ia ka sqaruar AKP-së se para dhe pas konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999, bartësi i së drejtës pronësore është dashur të jetojë në Rozhajë të Malit të Zi ku edhe tani jeton. Po ashtu është sqaruar se bartësi i së drejtës pronësore kishte pasur një “para-kontratë” me NSH-në në vitin 2002. Në vitin 2004, ai kishte lidhur një kontratë shitblerje me këtë ndërmarrje. Megjithatë, ai asnjëherë nuk ka qenë në gjendje që të hyjë në posedim të pronës. Paraqitësi i kërkesës pranon se pamundësia e ushtrimit të së drejtës pronësore nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur.

AKP-ja ka bërë procedimin e lëndës. Njoftimi i pronës së kërkuar është bërë me 21 nëntor 2011 në prani të përfaqësuesit të palës përgjegjëse në kërkesë “I.”. Pala përgjegjëse në kërkesë formalisht është përgjigjur në kërkesë me 16 dhjetor 2008. Pala përgjegjëse në kërkesë ka pohuar se ndërmarrja është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe se lënda lidhur me pronën e kërkuar është duke u zhvilluar në gjykatë.

Gjatë procedimit të lëndës, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka vërtetuar se të dy ngastrat 7154/1 dhe 7155/1 janë objekt i procedurave të ndryshme pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Këto procedura janë iniciuar nga NSH-ja e lartpërmendur.

Me vendimin grupor KPCC/D/R/132/2011, të datës 26 tetor 2011 lidhur me lëndën e regjistruar në AKP me numrin KPA 00442, KKPK-ja ka pranuar se kërkesa bie jashtë mandatit të Komisionit të përcaktuar në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni ka vërejtur se bartësi i së drejtës pronësore e kishte blerë pronën në vitin 2001, ai asnjëherë nuk ka qenë në posedim të pronës dhe se “ai nuk e kishte humbur posedimin ... si rezultat i konfliktit të armatosur”.

Pas vendimit grupor, me 16 janar 2012, KKPK-ja ka nxjerrë një vendim individual.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 10 shkurt 2012.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur ankesë me 12 mars 2012.

Vendimi kundërshtohet “në bazë të arsyeve të parapara me ligj”, siç ceket në ankesë.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Dita e fundit e afatit të paraparë bie me 11 mars 2012, që është e diele, 12 mars 2012.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë, lënda nuk është në juridiksion të KKPK-së.

Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërliken drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Sipas nenit 2, Parimet e përgjithshme, pika 2.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 të ndryshuar me Ligjin. 03/L-079 “Çdo person që ka pasur të drejtën pronësore, posedimin e ligjshëm apo çfarëdo të drejthe të ligjshme në pronë të paluajtshme private, i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave drejtpërdrejt të lidhura me konfliktin e armatosur apo që kanë rezultuar nga ai, i cili ndodhi prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999 ka të drejtë në rikthimin e së drejtës së tij në pronë, në cilësinë e poseduesit të së drejtës në pronë”.

Interpretimi gramatikor (shfrytëzimi në kohën e kaluar i foljes 'kam', dmth. "kam pasur") dhe interpretimi historik (konteksti socio-historik në të cilin është krijuar rregullorja – për të siguruar kthimin e të drejtave që kanë ekzistuar deri në kohën e konfliktit) i këtij neni, që të dy tregojnë se ligjvënësi nuk ka pasur për qëllim që të krijojë një ligj që do t'i shërbente zgjidhjes së çfarëdo lloji të kontestit pronësor, por vetëm që të krijojë një instrument ligjor për kthimin e të drejtave pronësore të personave të cilat ata i kanë pasur deri në kohën e shpërthimit të konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999. Prandaj, çdo e drejtë pronësore, e fituar post factum, pas shpërthimit të konfliktit të armatosur nuk duhet të trajtohet nga Agjencia Kosovare e Pronës.

Në rastin aktual, nuk është e kontestueshme nëse ndonjëherë bartësi i së drejtës pronësore kishte fituar të drejtat pronësore në vitin 2002 apo 2004, por ai asnjëherë nuk ka qenë në posedim të pronës, as para e as pas konfliktit të armatosur.

Pasi që kërkesa nuk është në juridiksion të KKPK-së, Komisioni nuk është dashur të vendos rreth pronësisë së palës ankuese.

Duke ndjekur të njëjtën linjë – për shkak të mungesës së juridiksionit, Gjykatat nuk duhet të vendos nëse pala ankuese është apo nuk është pronar i pronës së kërkuar.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €

Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet të jetë 783000 €: 3965 € (3965 € = 50 € + (0,5% e 783000 €) por jo më shumë se 500 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin brenda 90 ditëve pas dorëzimit të aktgjykimit.

Këshillë juridike

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it